



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit dhe nenit 23 paragrafit 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit anonim, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 30.12.2020 morri

### VENDIM

Procedura për lëndën 12-3270 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit me numër 12-3270/1 me datë 25.06.2019, dorëzuar deri te KSHPK, nga parashtues anonim, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me nr.12-3270 të viti 2019, në rastin e lëndës vepohet nga organ tjetër kompetent – PTHP – Prilep.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) dita nga dita e marrjes së vendimit.

### Sqarim

Lënda me numër 12-3270 nga viti 2019 është formuar pas denoncimit për dyshime për korrupsion nr. 12-3270/1 me datë 25.06.2019, të dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga ana e parashtruesit anonim, denoncim anonim.

Në denoncim ka akuza kundër këshilltarit në Këshillin e Komunës ..... për ekzistimit të dyshimeve për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit, i cili me pjesëmarrje në punën e Këshillit për marrje të tendereve në Shtëpinë e pleqve ” ..... ” ka ndikuar në kompaninë për furnizime ” ..... ” f. ...., te e cila si udhëheqës ka qenë bashkëshortja e tij. Gjithashtu në denoncim theksohet se personi i emëruar e ka keqpërdorur pozitën zyrtare dhe autorizimit me marrje të tendereve në Kombinatin e Duhanit SHA Prilep, në lidhje me transportin e duhanit nga Prilepi në Kavadarç për të cilën është zgjedhur ndërmarrja ....., në të cilën ai ka qenë udhëheqës.

Gjatë rishikimit të rasti të lëndës Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) i merr parasysh të gjitha akuzat e parashtruesit dhe për caktimin e gjendjes së përgjithshme faktike për këtë rast KSHPK dorëzoi kërkesë për të dhëna dhe informacione deri tek institucionet kompetente, dhe njëherit në lidhje me akuzat e lëndës janë bërë inspektive në evidencën interne të KSHPK. Nga procedura e bërë për caktimin e gjendjes faktike, KSHPK e konstatoi gjendjen vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për akuza kundër personit ..... nga f. ...., anëtarë i Këshillit të Komunës ....., i cila ka qenë zgjedhur në këtë funksion me datë 30.10.2017. Në denoncimin e dorëzuar theksohet se kopje e të njëjtës do të dorëzohet edhe deri tek PTHP në Prilep që të vepron në kuadër të autorizimeve të veta dhe të ndërmarrin masa adekuate.

- KSHPK bëri kontrollim në evidencën elektronike në Regjistrin qendror të RMV nga i cili i morri gjendjet rrjedhëse për personat juridik të theksuar dhe nga kontrollimi është konstatuar se themelues i Ndërmarrjes shoqërore Shtëpi për pleq ..... është Komuna ..... , kurse SHA ..... pronësia është e padefinaur.
- Nga kontrollimet e bëra në web-faqen e Drejtorisë për të ardhura publike, KSHPK morri të dhëna për shoqëritë tregtare të theksuara në denoncim, kurse nga sistemi për evidencë elektronike të Regjistrin qendror të RMV është nxjerrë gjendja rrjedhëse dhe për "SHPKNJP ..... " dhe për "..... SHPKNJP", të dyat nga ..... nga të dhënat e mbledhura, është konstatuar se për Shoqërin tregtare "SHPKNJP ..... " në pronësi dhe autorizim të personit të regjistruar si ....., kurse në shoqërinë tregtare "..... " e cila është themeluar me datë 07.10.2014, në cilësi të pronarit është shënuar personi ....., kurse kontakti në numrin e telefonit në të dhënat e mbledhura nga ana e Drejtorisë për të ardhura publike, në realitet paraqesin numri i telefonit celular i personit të njëjtë të cilin e ka denoncuar dhe në Deklaratën për interesa dorëzuar deri tek KSHPK.
- Nga kontrollimi i bërë në evidencën të KSHPK, është ardhur deri në njohuri se personi i emëruar si personi zgjedhur për anëtarë në Komunën ....., e ka plotësuar obligimin e vet ligjor dhe deri tek KSHPK ka dorëzuar Listë anketuese dhe Deklaratë të interesave me datë 29.11.2017, kurse në Deklaratën e dorëzuar për interesat në faqen nr 5 në pjesën III.2.2 ka paraqitur se bashkëshortja e tij është udhëheqëse në ndërmarrjen "SHPKNJP ..... ", mirëpo në faqe 3 nga e njëjta në pjesën III.1.2 – Shoqëri tregtare, nuk ka paraqitur se ai është pronarë i shoqërisë tregtare. Nga këtu del se personi ..... në cilësi të anëtari të Këshillit të Komunës ....., gjatë dorëzimit të Deklaratës deri tek KSHPK në nëntor të vitit 2017, nuk ka paraqitur se është pronar i ndërmarrjes tregtare, dhe gjithashtu edhe në Listën anketuese në pjesën e pjesëmarrjes nuk ka plotësuar të dhëna për të njëjtën.

Gjatë kontrollimit nga Njësisë për parandalim të konfliktit të interesave pran KSHPK, është konstatuar se personi i përmendur mund të ishte edhe udhëheqës i shoqërie tregtare edhe këshilltarë në Komunë, për arsye se në përputhje me nenin 45 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (LPKKI) në të cilën janë theksaur kufizimet për kryerje të aktiviteteve gjatë kohës së kryerjes së funksionit – ky person bënë pjesë në "përrjashtim bëjnë personat të cilët marrin funksion i cili nuk është profesion, derisa menaxhimi me shoqëri tregtare ose institucion si pronar, është i obliguar që para se të merr funksionin e menaxhimit t'ia beson personi tjetër ose trupi, përveç anëtarëve të familjes së vet, gjatë kohës së kryerjes së funksionit, autorizime publike ose obligime" ... mirëpo në deklaratën për interesa të cilën e ka dorëzuar deri tek KSHPK ai është duhur të vepron në përputhje me nenin 45 dhe 82 nga LPKKI dhe ta paraqet të dhënë se ka qenë pronar i shoqërisë tregtare, për të cilën mosveprimi gjegjësisht mos dorëzimi i të dhënave në formularin e dorëzuar në përputhje me LPKKI është paraparë gjobë dhe e njëjta iu nënshtrohet veprimeve për kundërvajtje dhe sanksione. Mirëpo, përshkak të faktit se veprimi është bërë në nëntor të vitit 2017 është konstatuar se kundërvajtja është vjetërsuar dhe KSHPK nuk është në gjendje që të ngritë procedurë të kundërvajtjes kundër këtij personi.

Njëherit, nga Njësia për parandalim të konfliktit të interesave pran KSHPK është formuar lëndë me numër 09-3665/1 me datë 24.07.2019, e cila është formuar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, dorëzuar deri tek KSHPK kundër personit ..... anëtar i Këshillit të Komunës ....., me akuzë se ai si anëtar i Këshillit të komunës, duke shfrytëzuar pozicionin e tij zyrtar dhe autorizimin ka ndikuar në realizimin e procedurës për furnizime publike për qumsht, prodhime të qumshtit dhe prodhime bujqësore për nevojat e shtëpisë së pleqve ... dhe ka siguruar që tenderin ta fiton ndërmarrja e bashkëshortes së tij ....., duke theksuar se Shtëpia e pleqve është nën kompetenca të Komunës .....

Ky denoncim në realitet paraqet plotësim i denoncimit vetëmse të dorëzuar për akuzat e rastit. Në lidhje me këtë lëndë, KSHPK që të cakton gjendjen faktike dhe vërtetimin e akuzave në denoncim, kërkoi informacione dhe të dhëna nga organete kompetente dhe institucionet, me çka është konstatuar se akuzat e denoncimit nuk janë vërtetuar, gjegjësisht personi ..... si anëtar i këshillit të komunës së ..... nuk ka pasur ingjerenca që të ndikon në realizimin e procedurës për furnizime publike në institucione tjera, si dhe atë se çdo institucion në kuadër të organizimit të vet të brendshëm ka sektore të veçanta dhe adekuat dhe njësi të cilët bëjnë punët për furnizimet publike, dhe në ato punojnë persona me njohuri profesionale dhe kualifikime të cilët realizojnë furnizimet e nevojshme që të plotësohen kërkesat e vetë institucionit, dhe prej këtu nuk mund të flitet për ndikim të personit që është këshilltarë në komunë, por nuk është i punësuar në institucionit që ka bërë furnizimin e rastit dhe nuk ka marrë pjesë në realizimin e procedurës. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK duke vepruar për këtë lëndë në seancën e 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 vendosi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën e formuar pas denoncimit me numër 09-3665/1 me datë 24.07.2019.

- Me datë 19.05.2020, me kërkesë të KSHPK, është dorëzuar përgjigje nga .....SHA Prilep, me të cilën lajmërohet se kjo SHA e cila është një nga blerësit më të mëdhej të duhanit në vend, në përputhje me Ligjin për duhan dhe prodhime të duhanit, ka bërë rreth 4000 kontrata me kooperantë individual – prodhues të duhanit dhe nga të njëjtit kooperant ka blerë sasinë e kontraktuar të duhanit, rreth, 2.900.000 kg në vitin 2019 dhe duke krahasuar me vitin paraprak janë blerë sasi më të mëdha të duhanit. Për këtë qëllim ..... SHA Prilep, në përputhje me dispozitat ligjor në Statusin e shoqërisë së ... SHA Prilep ,e datë 28.06.2019 dhe Procedura e furnizimit me mallra dhe shërbimeve në ..... SHA SHA Prilep me datë 19.10.2018 ka bërë marrveshje për transport nga pikat e tubimit deri në magazinat e ..... SHA Prilep dhe marrveshje për transport të duhanit të tubuar nga magazinat e ..... SHA Prilet deri në Kavadarç.

Procedura për kontraktik të marrveshjeve është realizuar në përputhje me Procedurat ekzistuese për furnizime të mallrave dhe shërbimeve në ..... SHA Prilep të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të ..... SHA Prilep, sipas të cilës çdo furnizim të mallrave të veçantë dhe shërbimeve me vlerë deri në 30000 euro pa llogaritur TVSH zgjedhjen e ka bërë Komisioni në përputhje me Vendimin për formimin e komisionit i miratuar nga Drejtori gjeneral ekzekutiv në ..... SHA Prilep në bazë të ofertave të dorëzuara, dhe çdo furnizim i cili ka qenë me vlerë mbi 30000 euro në bazë të

procedurës së theksuar nevoja për transport të duhanit nga pikat mbedhëse deri në magazinat e ..... SHA Prilep është bërë marrvëshje për transport të kutiave të kartonit dhe duhanit me Shoqërinë për transport, tregëti me shumicë dhe pakicë ..... në bazë të zgjedhjes nga komisioni si ofertë më e volitshme nga të gjitha ofertat.

Ajo që ka të bëjë me transportin e duhanit nga magazinat e ..... SHA Prilep deri në Kavadarç, duke pasë parasysh faktin që këtë vit në krahasim me vitin e kaluar është blerë sasi më e madhe duhanit dhe sasia e përgjithshme e duhanit për përpunim në kutia kartoni nga mbledhja e vitit 2019 do të përpunohet dhe paketohet në përputhje me Kontratën për shërbime, duhanit i butë dhe i thatë – shërbimi soft draing në Kavadarç dhe gjatë asaj për krahasim është marrë çmimi nga viti i kaluar për transport të duhanit deri në Kavadarç, në përputhje me Procedurën për furnizime të mallrave dhe shërbimeve në ..... SHA Prilep është vepruar kah procedura për furnizime të shërbimeve me vlerë mbi 30000 euro pa llogaritur TVSH duke publikuar në Konkurs publik në shtypin ditor. Për këtë qëllim në përputhje me procedurat, është vepruar me dorëzim kërkesë deri tek Bordi i drejtorëve, që të miraton vendim për furnizim të shërbimit – sigurimi i transportit të duhanit nga mbledhja e viti 2019 deri në Kavadarç dhe miratimi i vendimit nga ana e Bordit të drejtorëve për furnizim me shërbimin – transport i duhanit nga mbledhja e vitit 2019 dhe në krahasim të tërë procedurës në përputhje me Procedurën e përmendur për furnizim me mallra dhe shërbime në ..... SHA Prilep, është kontraktuar marrëveshje për shërbim – transport i duhanit me datë 09.03.2020 me Shoqërinë për transport, tregti me shumicë dhe pakicë .....

SHA ..... Prilep ka lajmëruar KSHPK se në lidhje me bashkëpunimin afarist shumëveçar me Shoqërinë e transportit, tregtisë me shumicë dhe pakicë ..... mund të theksohet se marrëveshjet në mes tyre janë të bazuara në profesionalizëm dhe korektësi në realizimin e shërbimit të kontraktuar – transport të duhanit.

- Deri në KSHPK është dorëzuar lajmërim nga Shtëpia e pleqve ”.....” me datë 21.05.2020, me të cilën lajërohen se në bazë të procedurave për furnizime publike të cilat janë realizuar pas konkursit publik për furnizime publike, janë realizuar disa furnizime publike ndërmjet ”Shtëpia e pleqve .....” dhe shoqërisë tregëtare ..... dhe janë kontraktuar disa marrëveshje dhe atë: Marrëveshje për furnizime me produkte ushqimore në përputhje me shpalljen me numër 1/2019 për pjesën 2 dhe pjesën 4, numri protokolar i tyre ..... me datë 08.03.2019; Marrëveshje për furnizim me produkte ushqimore në përputhje me procedurën e shpallur me numër 2/2019 për pjesën 2 dhe pjesën 4, numri protokolar i tyre ..... me datë 08.03.2019; Aneksi i Marrëveshjes për furnizime me produkte ushqimore në përputhje me procedurën e publikuar me numër ..... për pjesën 2 dhe pjesën 4, numri protokolar i tyre ..... me datë 27.12.2019 dhe Aneksi i Marrëveshjes për furnizime me produkte ushqimore në përputhje me procedurën e publikuar me numër ..... për pjesën 2 dhe pjesën 4, numri protokolar i tyre ..... me datë 27.12.2019.
- Me datë 09.09.2020 pas kërkesës nga KSHPK, PTHP Prilep lajmëron se deri të kjo prokurori është dorëzuar parashtrësë anonime kundër personit ..... , kurse në raport me akuzat e njëjta të lëndës. Pas parashtrësë së dorëzuar është formuar lëndë me numër Po.nr ..... , pas të cilës PTHP Prilep ka ndërmarrë veprime për kontrollimin e akuzave me urdhër deri në MPB-Prilep për mbledhje të dëshmive dhe


njëherit është dhënë urdhër shtesë me qëllim të caktohet involvimi i personit të përmendur në procedurën e përmendur për furnizime publike në personat juridik të përmendur, që don të thotë se pas formimi të lëndës në PTHP Pripel procedura ende është në vazhdim dhe se ende nuk është marrë vendim nga prokuroria publike.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të caktuar, KSHPK konstatoi se në rastin konkret në lidhje me akuzat e lëndës për dyshime për ekzistimin e konfliktit të interesave tek personi i përmendur vetëmse është vepruar nga ana e Njësisë për parandalim të konfliktit të interesave pran KSHPK dhe është miratuar vendim nga veprimi kompetent i KSHPK, dhe në lidhje me gjendjen e konstatuar për mosdorëzimin e të dhënave në formularin Deklaratë për interesat të cilën personi i përmendur e ka dorëzuar deri tek KSHPK në muajin nëntor të viti 2017 si formular jo i plotë, KSHPK nuk është në gjendje të ngritë procedurë për kundërvajtje kundër këtij personi për faktin se veprimi ka ndodhur në muajin nëntor të viti 2017, dhe se kundërvajtja është vjetërsuar. Në lidhje me akuzat për involvim të personit të përmendur në procedurën për furnizime publike në personat juridik të përmendur në denoncimin e dorëzuar, vepron organ tjetër i cili është kompetent të vepron – PTHP Prilep, para të cilës zhvillohet procedura e cila ene është në vazhdim dhe për të cilën nga ana e prokurorisë publike nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar. Duke pas parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në procedurën për këtë lëndë, procedura për lëndën të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke marrë parasyshë të gjithë të shënuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si në dispozitat e këtij vendimi.

**Është vendosur me datë 30 dhjetor të vitit 2020, me numër 12-1925/7**

Dorëzuar deri tek: Arkiva  
Pas përfundimit të KSHPK  
Punoi: J. C., Këshilltarë  
Miratoi: m-r V. G., Anëtari KSHPK



KOMISIONI SHTETËRORË PËR  
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Zëvendës-kryetarë: Sofka Pejovska Dojçinovska